



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

**INFORMACION për Web**

**Shqipëria dhe anëtarësimi i saj në KDNJ  
2015-2017**



## Informacion i përgjithshëm mbi KDNJ

Në kuadër të procesit të reformës tërësore të sistemit të OKB-së dhe në veçanti, në përpjekje për të rifituar reputacionin e OKB-së në fushën e të drejtave të njeriut, Paneli i Nivelit të Lartë mbi "Kërcënimet, sfidat dhe ndryshimin", rekomandoi krijimin e Këshillit për të Drejtat e Njeriut me një anëtarësi më të vogël, të kufizuar për vendet me standarde të larta për të drejtat e njeriut, si dhe me mundësinë për t'u mbledhur gjatë gjithë vitit. Mbi bazën e këtij propozimi u miratua në AP të OKB-së rezoluta 60/251 për të shpërndarë Komisionin dhe për të krijuar Këshillin e të Drejtave të Njeriut. Këshilli filloi aktivitetin e tij në qershor 2006, duke u kthyer në një organ kryesor të Kombeve të Bashkuara për adresimin e çështjeve të të drejtave të njeriut. Parimet bazë për punën e ardhshme të KDNJ-së janë përcaktuar në 18 qershor 2007 dhe përfshijnë shtimin e dispozitave të reja dhe rishikimin e atyre ekzistuese si:

- ❖ Rishikimi Periodik Universal (UPR);
- ❖ Procedurat e Veçanta;
- ❖ Komiteti Këshillues për të Drejtat e Njeriut;
- ❖ Procedura e Ankimit.

Anëtarësia e KDNJ rinovohet çdo vit dhe përbëhet prej 47 vendeve, të cilët zgjidhen nga AP e OKB-së me mandat tre vjeçar, sipas përcaktimeve për çdo grupim rajonal:

Grupi Rajonal	Grupi afrikan	Grupi aziatik dhe pacifik	Grupi Evropës Lindore	Grupi Latin & Karaibet	Grupi Evropës Perëndimore & Të tjerë
Numri i vendeve	13	13	6	8	7

Gjatë vitit 2016 KDNJ ka këtë përbërje (listuar me rend alfabetik në gjuhën angleze) ku me shkrim të dalluar janë vendet që i përkasin grupit tonë rajonal: **Shqipëria**, Algjeria, Bangladeshi, Belgjika, Bolivia, Botsvana, Burundi, Kina, Kongo, Bregu i Fildishtë, Kuba, Ekuadori, Salvador, Etiopia, Franca, **Gjeorgjia**, Gjermania, Gana, India, Indonezia, Kenia, Kirgistani, **Letonia**, Maldives, Meksika, Mongolia, Maroko, Namibia, Holandë, Nigeri, Panama, Paraguai, Filipinet, Portugalia, Katari, Republika e Koresë, **Federata Ruse**, Arabia Saudite, **Slllovenia**, Afrika e Jugut, Zvicra, **ish Republika Jugosllave e Maqedonisë**, Togo, Emiratet e Bashkuara Arabe, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Venezuela, Vietnam.

## **I. Shqipëria dhe KDNJ**

Në tetor 2009 Shqipëria shpalli zyrtarisht kandidaturën e saj për anëtar në KDNJ për periudhën 2015-2017. Në zgjedhjet që u zhvilluan në Asambleenë e Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork në 21 tetor 2014, Shqipëria u zgjodh për herë të parë anëtare e KDNJ, me 176 vota. Shqipëria po shërben në KDNJ për një periudhë tre vjeçare, 1 janar 2015-31 dhjetor 2017.

Zgjedhja e Shqipërisë në KDNJ përbën njëherazi vlerësim dhe garanci për angazhimin e saj të përhershëm në çështjet e të drejtave të njeriut në të gjitha fushat. Gjatë gjithë këtyre viteve në demokraci, Shqipëria tashmë ka fituar një përvojë të gjerë në drejtim të promovimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Anëtarësimi në Këshillin e të Drejtave të Njeriut nënkupton për Shqipërinë njohjen e rrugës së gjatë që vendi ynë ka ndërmarrë në drejtim të realizimit të parimeve të lirisë, të drejtave të njeriut dhe demokracisë, si dhe shërben si një stimul i fortë për të vazhduar me vendosmëri rrugën për ndërtimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike. Shqipëria ka shumë për t'i ofruar botës nëpërmjet vlerave që e karakterizojnë si harmonia fetare, përkushtimi për fqinjësi të mirë, toleranca dhe mikpritja, si dhe nëpërmjet përvojës së përfutur gjatë reformimit të gjithanshëm që ka kaluar vendi.

Republika e Shqipërisë mbetet e përkushtuar për promovimin universal dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të tij, si dhe mbështet integrimin e dimensionit të të drejtave të njeriut në të gjithë Politikën e Kombeve të Bashkuara. Në planin kombëtar dhe në kuadër të anëtarësisë në KDNJ, objektiv madhor është integrimi i të drejtave të njeriut në axhendën e zhvillimit të pas 2015 (Sustainable Development Goals).

Respektimi dhe promovimi i të drejtave të personave që u përkasin minoriteteve dhe grupeve të rrezikuara në veçanti, do të mbetet prioritet i politikës së brendshme dhe të jashtme për Qeverinë Shqiptare. Hapa të mëdha janë bërë tashmë në Shqipëri në fushën e arsimit të minoriteteve, si dhe zhvillimin e të drejtave të tyre në sferat e jetës politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fetare.

Gjatë vitit 2015, Shqipërisë iu besuan postet e anëtares së Byrosë së KDNJ-së si dhe zëvendës-presidencës së KDNJ-së, si përfaqësuese e grupit të Evropës Lindore. Në shenjë vlerësimi të rolit të saj në KDNJ, gjatë vitit 2016, Shqipëria është zgjedhur në Grupin Konsultativ të KDNJ, si dhe kryeson Grupin e Evropës Lindore në KDNJ gjatë gjashtë mujorit të dytë të 2016.

## II. Prioritet e anëtarësisë së Shqipërisë në KDNJ

Gjatë tre viteve të anëtarësisë në KDNJ, Shqipëria ka këto prioritete kryesore:

**Lufta ndaj fenomeneve të lidhura më ekstremizmin e dhunshëm & Promovimi i tolerancës dhe bashkëjetesës paqësore midis komuniteteve.** Shqipëria, duke pasur parasysh vendndodhjen e saj gjeografike, trashëgiminë kulturore dhe tolerancën që e karakterizon shoqërinë e saj, ka qenë vazhdimisht një promotor i dialogut, respektit dhe nxitjes së bashkëjetesës harmonike në mes besimeve të ndryshme, kulturave dhe civilizimeve. Shqipëria është vënë në krye të përpjekjeve për të promovuar dialogun dhe mirëkuptimin midis kulturave dhe qytetërimeve, me synimin për të shfrytëzuar këtë mjet në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtat e njeriut në mbarë botën.

**Të drejtat e fëmijëve:** Shqipëria është e angazhuar për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përputhje me angazhimet ndërkombëtare. Në hartimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor, institucional dhe politikave mbi të drejtat e fëmijëve, institucionet shqiptare udhëhiqen nga parimi i interesit më të lartë të fëmijëve dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për mirërritjen e tyre, mbrojtjen nga diskriminimi, mbrojtjen nga dhuna, format e ndryshme të abuzimit etj.

**Lufta kunder dhunës ndaj grave (dhunës në familje) & Barazia gjinore & Përkrahja sociale:** Një objektiv i rëndësishëm mbetet fuqizimi i përpjekjeve për të promovuar barazinë gjinore dhe të drejtat e grupeve të margjinalizuara, duke përfshirë këtu fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, si dhe personat e moshuar, me qëllim për të siguruar pjesëmarrjen e tyre aktive në shoqëri. Angazhimi për të ulur pabarazinë gjinore reflektohet në një rol proaktiv për përfshirjen e femrave në zhvillimin e shoqërisë, ku një vend i veçantë i rezervohet mundësimin të pjesëmarrjes së tyre aktive në realizimin e projekteve në terren dhe në takimet e forumet rajonale dhe ndërkombëtare.

**Mos diskriminimi:** Shqipëria do të vazhdojë të theksojë rëndësinë e promovimit dhe zbatimit në praktikë të parimeve të universalitetit dhe mosdiskriminimit, duke theksuar se të drejtat e njeriut janë universale dhe njëlojë të zbatueshme për të gjitha qeniet njerëzore, pavarësisht përkatësisë etnike, racës, orientimit seksual, etj.

**Heqja e dënimit me vdekje:** Shqipëria është e bindur se heqja e dënimit me vdekje do të kontribuojë për procesin e paqëtimit dhe të tolerancës në botë. Shqipëria ka qenë shumë aktive dhe e zëshme përse i përket diskutimeve në Asamblenë e Përgjithshme mbi këtë temë dhe i bën thirrje të gjitha vendeve që kanë ende një përjasje të tillë kombëtare, të miratojnë një Moratorium për pezullimin e ekzekutimeve si hap të parë për realizimin e synimit final për ndalimin total të dënimit me vdekje.

**Forcimi i mandatit të OHCHR:** Shqipëria mbështet fuqishëm përpjekjet për të forcuar Zyrën e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e

Njeriut dhe tashmë bashkëpunon ngushtë me Procedurat Speciale të Këshillit të të Drejtave të Njeriut. Shqipëria do të mbështesë çdo iniciativë që ka si qëllim forcimin e pavarësisë së mandatit të Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, si një nga parakushtet për të ushtruar si duhet dhe me efektivitet funksionet e tij.

**Mbështetja për universalitetin e UPR:** Republika e Shqipërisë mbështet fuqimisht Mekanizmin Universal të Rishikimit Periodik (UPR), dhe e vlerëson krijimin e tij si një arritje të rëndësishme dhe risi të procesit të reformës së sistemit të të drejtave të njeriut të OKB-së. Shqipëria beson se UPR shërben si një instrument universal i vlefshëm për të gjitha vendet, në drejtim të promovimit të dialogut për çështjet e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar, si dhe ndjekja e procesit të gjeneruar që UPR u siguron vendeve një progres domethënës në hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre në rrafshin kombëtar.

**Promovimi i demokracive të reja:** Shqipëria beson se përfaqësimi i demokracive të reja dhe shteteve të vogla përbën në vetvete një vlerë të shtuar në punimet e Këshillit. Por, përtej kësaj, për shkak të historisë së saj të veçantë dhe ndjeshmërisë së lartë ndaj të drejtave të njeriut, Shqipëria do të angazhohet për të ofruar një perspektivë kombëtare në diskutimet dhe mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në të gjithë botën.

**Promovimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve:** Shqipëria do të vazhdojë të zbatojë të njëjtin kurs në politikën e saj të jashtme, duke luajtur një rol aktiv në rajon, në promovimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve, me qëllim të garantimit të një mjedisi të sigurt për respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

### **III. Gjurmët e Shqipërisë në Këshillin e të Drejtave të Njeriut**

Shqipëria, gjatë gjithë aktivitetit të deritanishëm në kuadër të anëtarësisë në KDNJ, ka qenë mjaft aktive dhe ka ndikuar në përmirësimin e mënyrës së funksionimit të KDNJ dhe në marrëdhëniet midis organeve të OKB në Gjenevë dhe Nju Jork, si dhe në rritjen e efektivitetit të punës së KDNJ, duke u bërë pjesë e vendimmarrjes në të.

Ky qëndrim aktiv e konstruktiv ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e imazhit të vendit dhe rritjen e vizibilitetit të Shqipërisë. Opinioni i delegacionit të Shqipërisë kërkohet, jo vetëm për miratimin e rezolutave, por edhe për çështje të rëndësishme që lidhen me përmirësimin e punës së KDNJ, rritjen e efikasitetit si dhe ndikimit të KDNJ e mekanizmave të tij në kuadrin e OKB-së.

Anëtarësimi i Shqipërisë në Grupin Konsultativ të KDNJ, ka rritur vëmendjen ndaj vendit tonë, si këshilluese në caktimin e personave të ngarkuar për mbajtjen e mandateve në mekanizmat e KDNJ, Raporterëve Specialë, anëtarëve të grupeve të punës, etj, në zbatim të rezolutave të miratuara nga KDNJ. Kjo ka bërë që edhe vende, të cilat nuk e njihnin Shqipërinë më parë, të kërkonin informacion, apo ndihmë për kandidatura apo persona të caktuar, si formalisht ashtu dhe në rrugë jo zyrtare.

Në cilësinë e anëtarit të KDNJ Shqipëria ka marrë pjesë në "Core Group" të disa prej rezolutave më të rëndësishme.

Ndërhyrjet në cilësinë kombëtare janë përzgjedhur për tematikat më kyçe të secilit sesion. Këto ndërhyrje kanë qenë në numër të konsiderueshëm, si dhe janë kombinuar me mbështetjen nga ana jonë të "Joint Statements" dhe Deklaratave të BE, duke krijuar kështu një prezencë të vazhdueshme të delegacionit tonë në punimet e KDNJ-së.

Angazhimi dhe bashkëpunimi me vendet partnere ka qenë shumë aktiv e intensiv, realizuar kjo si në takimet bilaterale informale ashtu edhe me pjesëmarrje në negociata formale të pjesës më të madhe të rezolutave, të cilat janë miratuar me votë.

Shqipëria ka bashkësponsorizuar një numër të konsiderueshëm rezolutash, ka bërë shpjegim vote, ka bërë propozim amendimesh apo ka mbajtur qëndrime për çështje të rëndësishme të përgjithshëm.

Shqipëria mori pjesë aktivisht në lobimin për vendimin e Byrosë së KDNJ për "takimet speciale të KDNJ", (të kërkuara nga krerë të shtetesh, të cilët kërkojnë ta përdorin këtë forum për interesa shtetërore) takime, të cilat me unanimitet u vlerësuan të pavend në të ardhmen, pasi po krijohej precedent për përdorimin e KDNJ për qëllime politike.

Shqipëria ia ka arritur të shfrytëzojë me elasticitet veçorinë unike të anëtarësimin

në KDNJ, duke qenë vend kandidat për anëtare në BE, si dhe vend anëtar në Organizatën e Bashkëpunimit Islamik (OBI). Vlera e shtuar e Shqipërisë në këtë aspekt qëndron në:

- Inicimin dhe fillimin e negociatave për procedurat e sponsorizimit të rezolutave në Grup, të cilat përfunduan me një letër udhëzuese të Presidentit të KDNJ-2015 për rëndësinë e sponsorizimit nga secili shtet edhe brenda grupeve të shteteve;
- Inicimi i projektit pilot për sponsorizimin elektronik të rezolutave në Gjenevë. Mendohet se në muajin shtator do të fillojë të zbatohet sponsorizimi elektronik i rezolutave;
- Ri-dimensionimi i pozitës së vendit tonë në OBI, në mënyrë që qëndrimi i Shqipërisë të reflektohej në qëndrimet e kësaj organizatë në KDNJ.

#### **IV. Pasqyrë e aktivitetit vjetor të Shqipërisë në Këshillin e të Drejtave të Njeriut**

##### **a. Viti 2015**

Gjatë vitit të parë të anëtarësisë në KDNJ (2015), vendi ynë ka mbështetur rezoluta e ka mbajtur qëndrime kombëtare për të pasqyruar me koherencë politikën tonë të jashtme, si dhe për të dhënë kontributin tonë në trajtimin e tërësisë së tematikave të secilit sesion.

Gjatë negociatave të teksteve të rezolutave, delegacioni i Shqipërisë ka marrë pjesë aktive duke propozuar modifikime gjuhësore ose duke mbështetur propozimet për modifikime nga partnerët. Në votimin e rezolutave, në parim, Shqipëria është udhëhequr nga interesat e saj kombëtare.

Shqipëria ka patur vazhdimisht në qendër të vëmendjes ruajtjen e marrëdhënieve bashkëpunuese me OBI-n, si dhe forcimin e rolit ndërmjetësues të Shqipërisë midis OBI-t dhe BE/SHBA. Janë negociuar një pjesë e konsiderueshme e deklaratave të OBI-t gjatë sesioneve, duke propozuar gjuhë alternative, më të pranueshme për Shqipërinë dhe vendet partnere.

Vendi ynë ka influencuar në moderimin e deklaratave dhe qëndrimeve të OBI, në veçanti për problematikat e terrorizmit, konfliktin Palestinë/Izrael, lirinë e shprehjes, të drejtave të grave, barazinë gjinore dhe LGBTI, tematika prioritet jo vetëm për Shqipërinë por edhe për shumë vende të tjera anëtare dhe vëzhguese në KDNJ.

Gjatë **sesionit të 29-të** të KDNJ u shqyrtuan në total 59 raporte, si dhe u miratuan rezultatet e UPR-ve të 14 shteteve. U organizuan paralelisht me sesionin rreth 190 aktivitete. Shqipëria mbajti 12 deklaratata kombëtare, u bashkua me 5 "joint

statements", si dhe me tërësinë e deklaratave të BE-së, sipas pikave të agjendës së KDNJ.

Në kuadër të këtij sesiioni veçojmë aspektet e mëposhtme:

- Shqipëria ka sponsorizuar si "original sponsor" rezolutat: "Situata e të Drejtave të Njeriut në Bjellorusi", "Elimination of discriminations against women"; "Accelerating efforts to eliminate all forms of violence against women: Domestic Violence"; "The grave deterioration of HR and humanitarian situation in Syrian Arab Republic"; "Cooperation and assistance to Ukraine in the field of Human Rights"; "The right to education"; "Strengthening efforts to prevent and eliminate child, early and forced marriage".
- Shqipëria ka mbështetur "Joint statements" për "Situatën e të Drejtave të Njeriut në Burundi" dhe "Diskriminimin mbi bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor". Gjithashtu janë mbështetur deklaratat "Arbitrary detention of HR Defenders" dhe është prezantuar deklarata për "Parandalimin e dhunës ekstreme".
- Është marrë pjesë në mënyrë shumë aktive në katër raundet e negociatave për rezolutën "Mbrojtja e Familjes". Delegacioni ynë ka propozuar ndryshime gjuhësore ndaj tekstit të rezolutës.
- Shqipëria ka paraqitur dy amendime për rezolutën "Mbrojtja e Familjes", gjatë diskutimit dhe votimit të rezolutës. Shqipëria, nga ana procedurale, ka qenë një nga dy vendet iniciatore për këto dy amendime.
- Shqipëria ka mbështetur në Byronë e KDNJ si dhe me deklaratë në sallë, kërkesat e BE për organizmin e një Debatit të veçantë mbi krizën e migrimit.

Në **sesionin e 30-të** të KDNJ u shqyrtuan në total 70 raporte, u miratuan raportet përfundimtare të UPR-ve të 14 vendeve, u miratuan 29 Rezoluta, 2 Deklarata Presidenciale dhe një Vendim. Gjatë këtij sesiioni Shqipëria mbajti 11 deklaratat në kapacitet kombëtar, sponsorizoi 11 rezoluta, iu bashkua të gjitha deklaratave të BE-së dhe sponsorizoi 7 deklaratat ndër-rajonale.

Shqipëria ishte në listën e "vendeve bërthamë"(core group) të inicimit dhe miratimit me sukses të një rezolute të re në KDNJ për luftën ndaj ekstremizmit të dhunshëm (CVE).

Gjatë këtij sesiioni për Shqipërinë ishin të rëndësishme negociatat për heqjen e terminologjisë "Serbia including Kosovo" në Raportin e Grupit të Punës për Zhdukjet me Forcë. Raporti i Grupit të Punës për Zhdukjet me forcë, si dhe adendumet ku gjendeshin referenca për Kosovën, u ri- publikuan në një version "corrigendum", ku e gjithë terminologjia u riformulua "Serbia and Kosovo".

Negociatat për sponsorizim vetëm në cilësi kombëtare të rezolutave; amendimeve, deklaratave në KDNJ.



Falë lobimit intensiv të delegacionit të SHBA-ve dhe Shqipërisë, në Grupet Rajonale, në takimet bilaterale dhe në Byronë e KDNJ-së, po shqyrtohet mundësia për sponsorizim vetëm në cilësi kombëtare.

Miratimi në KDNJ i rezolutës për të Drejtat e Njeriut dhe Parandalimin e Luftën ndaj Dhunës Ekstreme.

Shqipëria në cilësinë e anëtarit të "grupit bërthamë" të kësaj rezolute u angazhua në mënyrë shumë aktive në negociatat për finalizimin e tekstit të kësaj rezolute të re në KDNJ.

## **b. Viti 2016**

Gjatë vitit 2016, duke u nisur nga eksperiencia dhe nga arritjet inkurajuese të vitit të kaluar, Shqipëria vijoi përpjekjet për realizimin e prioriteteve të mëposhtme:

- Ruajtja e vizibilitetit dhe rolit aktiv të Shqipërisë në KDNJ;
- Rritja e influencës në KDNJ përmes përfaqësimit në Grupin Këshillues të KDNJ dhe në drejtimin e Grupit Rajonal të Evropës Lindore gjatë gjashtëmujorit të dytë të 2016;
- Ruajtja dhe forcimi i rolit moderator në OBI;
- Ruajtja e lidershit nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në "core group" të rezolutës "Countering Violent Extremism";
- Negocimi dhe ruajtja e konsensusit për Rezolutën "Liria e Fesë, Besimit" (BE) dhe "Lufta kundër diskriminimit mbi baza fetare (OBI)", si dhe mbështetja e vendeve partnere në miratimin me sukses të Rezolutës për SOGI.

Në **sesionin e 31-të** të KDNJ u shqyrtuan, në total, 81 raporte dhe u procedua me miratimin e përfundimeve të UPR-ve të 14 shteteve, miratimin e 40 teksteve, ndër të cilat 37 rezoluta, 2 vendime dhe një Deklarate Presidenciale.

Vlen të theksohet, se gjatë këtij sesioni Shqipëria, në emër të "vendeve bërthamë", prezantoi një rezolutë të re mbi situatën e të drejtave të njeriut në Sudanin e Jugut, e cila u miratua me konsensus.

Në kuadër të objektivit të pjesëmarrjes aktive në punimet e KDNJ, Shqipëria mbajti 22 ndërhyrje në kapacitet kombëtar, si dhe zhvilloi mbrojtje aktive gjatë shqyrtimit të rezolutave për çështje të ndryshme tematike dhe me prioritet për anëtarësinë e vendit tonë në KDNJ.

Edhe gjatë sesionit të 31-të Shqipëria luajti një rol aktiv në arritjen e konsensusit dhe mos kalimin me votë të dy rezolutave të mbrojtura nga BE dhe OBI. Mbas shumë përpjekjeve, përfshi këtu edhe rolin moderues të Shqipërisë, në fund u arrit konsensusi për miratimin e të dy rezolutave.

Shqipëria mori pjesë aktive në negociatat intensive për përmirësimin e tekstit dhe

zgjerimin e mbështetjes ndaj rezolutës "Human Rights and preventing and countering violent extremism"(CVE), duke qënë pjesë e 'core group'. Shqipëria ishte bashkë organizator i një paneli mbi CVE-të gjatë këtij sesioni.

Gjatë këtij sesioni Shqipëria luajti një rol të shtuar për sa i përket ruajtjes së konsensusit të miratimit të rezolutave FORB e BE-së dhe 16/18 e OBI. Të dy këto rezoluta trajtojnë lirinë e besimit dhe të fesë, por nga këndvështrimet e organizatave respektive.

Gjatë sesionit të 31, Shqipëria arriti të moderojë gjuhën e disa deklaratave në tërësinë e tyre dhe në veçanti zbutjen e qëndrimeve në lidhje me çështjet gjinore, HIV/AIDS, LGBTI dhe Palestinën. Negociatat janë zhvilluar në frymë konstruktive dhe vendi ynë ka arritur që pjesa më e madhe e propozimeve të tij të miratohen prej anëtarësisë së OBI-it në grup.

Shqipëria ka patur një vizibilitet maksimal edhe gjatë **sesionit të 32-të**, i cili i mbylli punimet gjatë verës. Dhe kjo edhe për shkak të qëndrimit tonë ndaj rezolutës SOGI. Delegacioni i Shqipërisë ka bashkësponsorizuar si "original sponsor" rezoluta të cilat trajtojnë tematika me prioritet të lartë për Shqipërinë dhe vendet partnere të saj.

Shqipëria, gjatë këtij sesioni, ka mbajtur 16 deklarata kombëtare në 19 tematika të KDNJ, si dhe ka mbështetur 4 "joint statements" dhe është bashkuar me 9 deklarata të BE.

Edhe në sesionin e **33-të** të KDNJ, Shqipëria ka pasur një pjesëmarrje të spikatur, duke marrë pjesë aktive në diskutime dhe dokumente të prodhuara. Janë mbajtur në cilësinë kombëtare 11 ndërhyrje; është shprehur qëndrimi i Shqipërisë kundër amendamenteve të 7 rezolutave; delegacioni ynë i është bashkuar 8 deklaratave të BE-së; kemi mbështetur 2 "Cross Regional / Joint Statements" dhe 14 deklarata të OBI-t; janë bashkë-sponsorizuar 15 rezoluta. Ndërhyrjet e Shqipërisë kanë pasë në qendër të trajtimit të tyre në këtë sesion situatën e të drejtave të njeriut në disa vende si Siria, Ukraina, Burundi, Sudani, ndërhyrjet për UPR-të e Greqisë, Hungarisë, Irlandës dhe Tailandës, për barazinë gjinore, të drejtat e popujve indigjen si dhe të të rinjve. Edhe gjatë këtij sesioni vendi ynë ka pasur një vizibilitet maksimal dhe ka dhënë kontributin e tij për zgjidhjen e një numër çështjesh me ndikim përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut.